



**VENDIM**

*Nr. 20, Datë 31.01.2017*

**MBI  
MOS FILLIMIN E PROCEDURËS SË LIÇENSIMIT TË SHOQËRISË  
“ENERGJI UNIVERS” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 6 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.01.2017, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi mos fillimin e procedurës për licensimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

- Në nenin 6 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” citohet se: “Ka të drejtë të aplikojë për një licensë të lëshuar nga ERE, çdo person që ka selinë e tij në Shqipëri, dhe me objekt të veprimtarisë aktivitetin e kërkuar për licensim.”
- Shoqëria “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, nuk rezulton që në objekt të veprimtarisë së saj të ketë parashikuar tregtimin e energjisë elektrike.
- Aplikuesi nuk ka të drejtë të aplikojë për një licensë në aktivitetin e tregëtimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për licensimin e shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për  
Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30  
ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

*VENDIMIN*

*Nr. 20, Datë 31.01.2017*

**MBI  
MOS FILLIMIN E PROCEDURËS SË LIÇENSIMIT TË SHOQËRISË  
“ENERGJI UNIVERS” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____